



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:274302
Datë: 19.06.2024
Numri i dokumentit: 05835958

KF.nr.340/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, megjyqtaren Vera Gashi Bala, në konfliktin tregtar administrativ të paditësit “Auto Sherreti” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810659039 dhe seli në Ferizaj, përfaqësuar nga Kushtrim Bytyqi, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimi, objekti i kontestit rivlerësim malli, vlera e kontestit e papërcaktuar, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur me datë 13.06.2024 në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse avokat Kushtrim Bytyqi dhe përfaqësueses të palës së paditur Krenare Shala, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Auto Sherreti” Sh.P.K., me seli në Ferizaj.
- II. ANULOHET Aktvendimi me nr. 01.3.2.2/4288/2019 i datës 05.11.2021, i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. OBLIGOHET e paditura Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit “Auto Sherreti” Sh.P.K., me seli në Ferizaj, t’ia kthej shumën prej 7,707.11 €(shtatë mijë e shtatëqindën e shtatë euro e njëmbëdhjetë cent), të paguar më tepër, në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratave Unike Doganore me numër: R- 5510/11.03.2019, R-5514/11.03.2019, R-5515/11.03.2019, R-5519/11.03.2019,R-5521/11.03.2019, R-5532/11.03.2019, R-6021/16.03.2019, R-6025/16.03.2019, R-6116/18.03.2019, R-6118/18.03.2019, R-6785/25.03.2019, R-7625/02.04.2019, R-7619/02.04.2019 dhe R-7610/02.04.2019 të ZBD Interevropa, me kamatë ligjore prej 8 % nga data 27.09.2019 deri në pagesën definitive.
- IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “Auto Sherreti” Sh.P.K., përmes përfaqësuesit të autorizuar, me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 07.12.2021, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me të cilën i ka propozuar gjykatës aprovimin e kërkesëpadisë si të bazuar, të anuloj si të pabazuar aktvendimin e Sektorit të Rishqyrtimeve të Doganës së Kosovës nr. 01.3.2.2/4288/2019 të datës 05.11.2021, dhe të detyroj të paditurën që t’i kthej mjetet e paguar në emër të detyrimeve të importit të paguara mbi vlerën e transaksionit. Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor publik përfaqësuesi i paditësit ka deklaruar se mbesin në tërësi si në theksuarat në padi dhe në deklaratimet në seancat e kaluara duke e precizuar kërkesëpadisë ashtu që vlera e kontestit në këtë lëndë dhe detyrimi i të paditurës që ti kthej paditësit mjetet e paguara më tepër në emër të detyrimeve të importit për shkak të rivlerësimit është në shumë prej 7,710.21 euro me kamatë prej 8% nga data 27.09.2019 që është data e fundit e DUD-it me regjim IM4. Ka shtuar se Kontratat e Shitblerjes për veturat e përdorura nuk përcaktohen si obligative në KDA e as në LMD, shtuar kësaj faktin se është në kundërshtim me logjikën tregtare të realizimit të fitimit që paditësi të udhëtojë në shtetet eksportuese për lidhjen e këtyre kontratave. Paditësi DUD-ve kontestues për qëllim të vërtetimit të çmimit të paguar për veturat përkatëse i ka bashkangjitur transaksionet bankare të cilat janë evidentuar në mënyrë të qartë edhe në ekspertizë financiare. Më tej ka theksuar se konsiderojnë se Dogana e Kosovës në bazë të KDA nuk ka mandat për barazimin e pagesave në emër të detyrimeve të importit, pastaj llogaritja e çmimit mesatar të veturave të ngjashme, konsiderojnë se është arbitrare pa e marrë parasysh gjendjen faktike të një veture përkatëse dhe nuk vërteton vlerën reale. Ndërsa në fjalën përfundimtare gjykatës i ka propozuar që të aprovojë kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të bazuar ashtu që të anuloj aktvendimin e atakuar dhe të obligoj të paditurën që ti kthej paditësit mjetet e paguara më tepër në emër të detyrimeve të importit për shkak të rivlerësimit në vlerë prej 7,707.11 euro me kamatë në shkallë prej 8% nga data 27.09.2019 e deri në pagesën e plotë.

E paditura në përgjigje në padi të datës 05.04.2021 e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Më tej ka shtuar se vendimi i atakuar është marr konform dispozitave në fuqi dhe pretendimet e palës paditëse për shkelje ligjore nuk qëndrojnë, për arsye se pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme duke i propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoi si të pabazuar. Gjatës seancës së shqyrtimit gjyqësor, ka deklaruar se e kundërshtojnë padinë dhe kërkesëpadinë e

paditësit në tërësi si dhe kundërshtojnë në tërësi ekspertizën financiare të përpiluar nga eksperti financiar, pasi që i njëjti nuk ka vërtetuar asnjë fakt relevant financiar duke dal jashtë detyrave të dhëna nga gjykata pasi që i njëjti ka bërë vlerësime juridike lidhur me çështjen kryesore të ngritur me padi (lidhur me ligjshmërinë e aktvendimit të atakuar me padi) vlerësime këto që ka të drejtë dhe kompetencë të bëjë vetëm gjykata. Tutje ka shtuar se Dogana e Kosovës sqaron se arsyeja e mospranimit të vlerës të deklaruar është se edhe përkundër faktit se posedon dokumentacion jo të kompletuar krejtësisht askund nuk është hasur në kontratë të shitblerjes edhe pse ka disa importe nga eksportues të njëjtë, madje për disa importe nuk ka të prezantuar transaksionin bankar apo nuk i ka të harmonizuar këto transaksione me cilin import është zhdoganuar, prandaj çmimi i deklaruar është në mospërputhje të madhe me të dhënat në dispozicion nga katalogu online i cili aplikohet në të gjitha rastet me qëllim të trajtimit të barabartë të subjekteve të ndryshëm në kuptim të pagesës së taksave, i cili katalog i referohet tregut të gjerë evropian që nxjerrë mesataren e çmimit për llojet e njëjta të veturave, andaj edhe gjendja faktike në kuptim të çmimit të mallit është jo proporcionale me çmimet e tregut evropian si në katalogun SCHWACKE.net. Ka theksuar se Dogana e Kosovës duke u bazuar në KDA pa rënë në ndesh në marrëveshjen e përgjithshme mbi tarifat dhe tregtinë ka fuqizuar formën dhe tregtinë e mallrave duke përdorur si pikë referimi këtë katalog që është në përputhje me nenin 36 të KDA-së me qëllim të eliminimit të përdorimit të burimeve të ndryshme të informimit jo zyrtar. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet në tërësi padia dhe kërkesëpadija e paditësit si e pabazuar, të marrë për bazë të gjitha shkresat e lëndës të administruara duke lënë në fuqi aktvendimin e atakuar me padi.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurë të provave të shqyrtimit gjyqësor-publik të datës 13.06.2024, ka administruar provat si në vijim: Aktvendimi nr. 01.3.2.2/4288/2019, DUD-at kontestues me IM4 dhe IM7, Faturat përcjellëse, Pagesat bankare, Deklaratat eksportuese, Ekspertizën financiare, Kontratën e datës 01.04.2008, Aktvendimin nr.01.3.2.2/4288 të datës 16.05.2019, Ankesa në doganë dhe Vlerësimet nga katalogu SCHWACKE.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, vlerësoi secilën provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga arsyetimi i vendimit kontestues gjykata konstaton se e paditura ka refuzuar ankesën e paditësit për arsye se vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është çmim real i paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë, për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport përkatësisht për import në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, andaj Dogana ka vendosur se çmimi i marr nga katalogu, është çmimi i caktuar në bazë të vitit të prodhimit, tipit dhe llojit të automjetit dhe në bazë të karakteristikave të tjera të cilat janë detajuar e sipas të cilave është caktuar vlera e mallit nga i cili është zbritur përqindja e amortizimit të automjetit. Lidhur me mospranimin e vlerës së deklaruar të DUD-ave edhe përkundër faktit se posedon dokumentacion, por jo krejtësisht të kompletuar sepse askund nuk është hasur kontrata e shitblerjes edhe pse nuk shihet se subjekti ka pas disa importe nga eksportues të njëjtë, mandej për disa importet nuk ka prezantuar transaksione bankare, apo nuk i ka harmonizuar këto transaksione se me cilën import është zhdoganuar dhe çmimi i deklaruar është në mospërputhje të madhe me të dhënat në dispozicionin nga katalogu.

Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas propozimit të të autorizuarit të palës paditëse përmes aktvendimit KF.nr.340/22 të datës 22.03.2024 ka caktuar ekspertizë financiare në këtë kontest tregtar administrativ me ekspertin e financiar SH.B. me detyrat përkatëse sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga mendimi dhe konstatimet e nxjerra të ekspertit financiar në ekspertizën e datës 14.04.2024, për detyrat e caktuara për ekspertizë është dhënë mendimi dhe konstatimi se: *Subjekti "Autosherreti" Sh.P.k., me seli në Prishtinë për të gjitha DUD-at kontestues që janë objekt i ekspertizës, janë të pajisur me Faturat blerëse për secilën veturë të deklaruar për doganim. Të gjitha DUD-at, kontestues të proceduar nga ZBD Interevropa, importuesi ka deklaruar për doganim vetura të ndryshme të përdorura, ku në secilën deklaratë doganore janë specifikuar përshkrimet e tyre të shoqëruar me vlerë n e faturave për secilën prej tyre. Për të gjitha faturat blerëse për DUD-at, kontestuese subjekti "Autorsherreti" Sh.P.K., me seli në Prishtinë, ka bërë pagesat nëpërmjet urdhër pagesat bankare të përshkruara për qëllimin e pagesës dhe datat e pagesave. Subjekti i "Autosherreti" Sh.P.K me seli në Prishtinë, me rastin e doganimit të veturave ka bashkëlidhur këto dokumente: Deklaratën eksportuese për secilin veturë të deklaruar për doganim, faturat blerëse për çdo veturë, urdhërpagesat bankare në emër*

të faturave, Vlerësimi i vlerës së mallit të importuar nga DUD-at, kontestues, dogana e Kosovës ngarkon subjektin “Autosherreti” Sh.P.K, me seli në Prishtinë me Taksë Doganore, Akcizë dhe TVSH në shumë prej 70, 691.77 €. Vlerësimi i vlerës së mallit të importuar sipas DUD-ave kontestuese, sipas vlerës së faturave të paguara bazuar urdhërpagesat bankare, për obligime për Takës Doganore, Akcizë dhe TVSH janë shumë prej 62,981.56 €. Diferenca e pagesës në mes të Vlerësimit Doganor dhe urdhërpagesat bankare, që subjekti “Autosherreti” Sh.P.K me seli në Prishtinë, ka paguar me tepër është në vlerë prej 7.710.21 €. Duke u bazuar në të gjeturat e gjendjes me ekspertizë financiare konstatoj se subjekti “Autosherreti” Sh.P.K, me pa të drejtë është ngarkuar me vlerën e taksave doganore për DUD-atë, kontestues shumën prej 1,688.64 dhe shumën për TVSH prej 6,021.57 €.

Gjykata e ka pranuar ekspertizën financiare të datës 14.04.2024 të ekspertit SH.B. në tërësi si të besueshme, pasi që e njëjta ishte profesionale dhe e argumentuar mirë në raport me detyrat.

Eksperti financiar në seancën e shqyrtimit gjyqësor – kryesor të datës 13.06.2024 ka deklaruar se mbetet në tërësi në ekspertizën financiare të punuar me datë 14.04.2024 e cila është punuar konform detyrave të përcaktuara nga gjykata me të cilën konkludimin e dhënë e ka mbështetur në dokumentacionin relevant e cila është në lëndën gjyqësore e precizuar me faturat blerëse për secilën veturë të deklaruar për doganim si dhe urdhërpagesat bankare në emër të faturave të shënuara. Tutje ka shtuar se kontesti diferencial në mes të vlerës së mallit të caktuar nga dogana dhe ekspertizës financiare ka rrjedhur se dogana vlerën e mallit të kontestuar lëndor dhe shpenzimet e transportit e ka vlerësuar me metodën e gjashtë të vlerësimit seksionit 35 dhe 36 të KDA dhe akcizave të Kosovës përkatësisht duke e marrë për bazë katalogun online SCHWACKE listë e cila grumbullon të gjitha çmimet e veturave të llojeve të ndryshme dhe bënë një çmim mesatar dhe ndërmarrjet apo firmat të cilat bëjnë importin, hulumtojnë tregun dhe gjejnë vetura edhe nën këtë çmim e cila është në këtë katalog dhe për secilën import për doganim paraqesin të gjitha shpenzimeve e faturave apo faturë apo dokumenteve përcjellës i paraqesin në Doganën e Kosovës. Ndërsa në ekspertizë janë marrë çmimet duke u bazuar në faturat blerëse duke paraqitur edhe shpenzimet e transportit dhe është formuar çmimin për secilin DUD doganor dhe është nxjerrë diferenca e çmimit e cila është e paraqitur në faqen 10 të ekspertizës.

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykatës i rezultoi një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ.

Gjykata vlerëson se e paditura pa bazë ligjore dhe prova materiale të besueshme e ka rivlerësuar mallin lëndor të deklaruar për zhdoganim nga paditësi, përmes DUD-ve R-5510/11.03.2019, R-5514/11.03.2019, R-5515/11.03.2019, R-5519/11.03.2019, R-5521/11.03.2019, R-5532/11.03.2019, R-6021/16.03.2019, R-6025/16.03.2019, R-6116/18.03.2019, R-6118/18.03.2019, R-6785/25/03/2019, R-7625/02.04.2019, R-7619/02.04.2019 dhe R-7610/02.04.2019 të ZBD Interevropa, dhe në këtë mënyrë të njëjtin e ka obliguar të paguaj një shumë më të madhe në emër të TVSH-së se sa që i ka takuar në bazë të vlerës së transaksionit. Po ashtu Gjykata konstaton se aplikimi i metodës së 6 të vlerësimit në vështrim të nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, është veprim i cili bie ndesh me dispozitat e nenit 33-35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L109, për arsye, se para se të aplikohet metoda e fundit e vlerësimit gjegjësisht metoda e 6 e vlerësimit, duhet të jepen arsyet dhe provat për ta kontestuar vlerën e mallit lëndor.

Gjykata nga shkresat e lëndës vlerëson se me asnjë provë nuk është provuar konstatimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar, sipas të cilit vlera e deklaruar e mallit lëndor nga paditësi, nuk është vlera reale e paguar e mallit me qëllim importi në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDAK-së. Gjykata konsideron se paditura do të mund ta mbështeste një konstatim të tillë vetëm atëherë kur do të mund të siguronte dëshmi konkrete se paditësi për mallin lëndor kontestues, i ka paguar eksportuesit mbi çmimin e faturës së mallit të paraqitura gjatë procedurës së zhdoganimit të mallit.

Me nenin 123 par. 1 pika (a) të UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109, është përcaktuar dokumenti që duhet bashkëngjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë të mallit, e që është *“fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti”*.

Gjykata konstaton se në rastin konkret paditësi ka paraqitur fatura të mallit lëndor dhe të cilat janë paguar përmes urdhërpagesave bankare ndërkombëtare me status të aprovuar, e të cilat janë të harmonizuara në tërësi në kuptim të shumës dhe pagesës së bërë. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se të gjitha këto dokumente rezultojnë të jenë të harmonizuara në tërësi sa i përket vlerës së mallit të importuar nga paditësi në kuptim të nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Prandaj nga gjendja faktike e vërtetuar më lartë, Gjykata pretendimet e paditësit lidhur me deklaratat unike doganore kontestuese, i vlerësoi si tërësisht të bazuar dhe se dokumentacioni

i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore për zhdoganimin e mallit lëndor, konform nenit 33 par.1 të Kodit Doganor dhe të Akcizave.

Gjykata konform nenit 46 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit nr.03/L- 202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ashtu që aprovoi kërkesëpadinë e paditësit, e anuloi vendimin e kontestuar të të paditurës dhe e detyroj të paditurën që paditësit t'i kthej shumën prej 7,707.11 €, të paguar më tepër për shkak të rivlerësimit jo të drejtë të mallit, në emër të detyrimeve importuese, për mallin e zhdoganuar përmes dudave kontestues të proceduar në ZBD Interevropa.

Sa i përket kamatës gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, sipas precizimit të kërkesëpadisë nga i autorizuari i paditësit bërë në seancën e shqyrtimit gjyqësor duke pasur parasysh dispozitën e nenit 292 pika b) (i), të KDAK-së nr.03/L-109, ku parashihet *“Në rast se çështja zgjidhet përfundimisht në instance të fundit sipas mjetit të ushtruar në favor: Të Apeluesit, Dogana duhet që: (i) të rikthejë çdo detyrim të importit apo eksportit të paguar më tepër bashkë me kamatën e grumbulluar deri në momentin e zgjidhjes së kontestit nëse është e aplikueshme”* dhe dispozitat ligjore të nenit 170 të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku thuhet se *“Detyrimi i shpërblimit të dëmit konsiderohet se ka arritur, për pagesë që nga momenti i shkaktimit të dëmit”* dhe nenit 382 paragrafi 2 të këtij ligji ku thuhet se *“Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*, ndërsa lidhur me datën e rrjedhës së kamatës sipas kërkesës së palës paditëse ka marrë datën 27.09.2019 që është data e fundit e DUD-it me regjim IM4.

Gjykata i ka vlerësuar deklaratimet dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative.

Vendimin që secila palë ti bart shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga të lartcekurat, gjykata konform nenit 46 par. 2, 4 dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.340/22 datë 13.06.2024

Gjyqtarja

Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.